



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 20, datë 29.05.2019

MBI

**“PROPOZIMIN PËR MIRATIMIN E TARIFAVE, TË CIKLIT TË DYTË TË  
STUDIMEVE, PËR STUDENTËT MBETËS DHE PËRSËRITËS, NË FAKULTETET  
E UNIVERSITETIT TË ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në pikën 3, shkronja ç të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.638, datë 22.07.2015 “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimit të ciklit të parë, në programet e studimeve jo-universitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, për vitin akademik 2015-2016” (i ndryshuar); nenin 22 të “Rregullores mësimore të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional, Master Shkencor dhe Master i Arteve në Universitetin e Arteve”; shkresën e Sektorit Mësimor me nr. 724/1 prot., datë 25.05.2019, shkresën e Departamentit KMDP të Fakultetit të Muzikës me nr. 180/1 prot., datë 21.05.2019 (protokolluar në Rektorat me nr. 724/1 prot., date 22.05.2019), shkresën e Fakultetit të Artit Skenik datë 23.05.2019 (protokolluar në Rektorat me nr. 760 prot., datë 23.05.2019) si dhe në propozimin e Rektorit të Universitetit të Arteve, Prof. Kastriot Çausi, pasi e diskutoi me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Propozimin për miratimin e tarifave, të ciklit të dytë të studimeve, për studentët mbetës dhe përsëritës, në Fakultetet e Universitetit të Arteve.
2. Studentët, të cilët nuk e kanë përfunduar programin përkatës të studimit apo nuk kanë shlyer të gjitha provimet e parashikuara në atë program studimi, në kohëzgjatjen normale të tij dhe konsiderohen student mbetës/përsëritës për lëndët përsëritëse, do të paguajnë vetëm tarifën vjetore të shkollimit.
3. Mbi kohëzgjatjen normale të shkollimit, studentët mbetës dhe përsëritës do të paguajnë tarifën për kredit.
4. Ky vendim ti dërgohet Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve për miratim përfundimtar.
5. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe te transparenca.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Asoc. Genc MULLIQI

Urim ALIAJ

Rajmond PRENDUSHI